

POLITIKA PËR AKREDITIM NDËRKUFITAR

DAK-PO-07

\

MIRATUAR NGA,
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Gentiana ISLAMAJ

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	4
5.1 Aplikimi nga një TVK që ndodhet brenda Evropës	4
5.2 Aplikimi nga një TVK që ndodhet jashtë Evropës	4
6. ANEKSET	5
7. REGJISTRAT	5
8. HISTORIA	5

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan politikën e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK) sa i përket akreditimit ndërkufitar në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 765/2008, EA-2/13 M:2019 dhe ILAC G21 M:2012.

2. REFERENCAT

- Rregullorja (KE) nr. 765/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 korrik 2008 që përcakton kërkesat për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut në lidhje me tregtimin e produkteve dhe shfuqizon Rregulloren (EEC) Nr. 339/93
- EA-2/13 M:2019 - Politika e Akreditimit Ndërkufitar EA dhe Procedura për Bashkëpunimin Ndërkufitar midis Anëtarëve të EA;
- EA-2/13 S1 M:2013 - Shtojca EA 1 e EA-2/13, Interpretimi i Terminologjisë së përdorur në pikën 5.1 të EA-2/13;
- ILAC G21 M:2012-Akreditimi ndërkufitar-parimet për shmangien e dyfishimit (dublifikimit).

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo politikë është e detyrueshme dhe vlen për të gjithë stafin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK-së që janë të përfshirë në akreditim (siç janë stafi i DAK-së, KP, KA, KT, vlerësuesit dhe ekspertët) dhe të gjithë Trupat për Vlerësimin e Konformitetit (TVK) që janë jashtë territorit të Kosovës dhe që kërkojnë akreditim nga DAK.

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimin e kësaj politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

TA	Trupi i Akreditimit
TVK	Trupi për vlerësimin e konformitetit
DAK	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës
EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
EA BLA	European Accreditation Bilateral Agreement (Marrëveshja për njohjen dypalëshe të EA)
EA MLA	European Accreditation Multilateral Agreement (Marrëveshja për njohjen shumëpalëshe të EA)
ILAC	International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar për Akreditimin e Laboratorëve)
ILAC MRA	International Laboratory Accreditation Council Multilateral Agreement (Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të ILAC)
KP	Këshilli Profesional
KA	Këshilli i Akreditimit

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

5.1 Aplikimi nga një TVK që ndodhet brenda Evropës

DAK pranon aplikime për akreditim nga TVK-të që ndodhen brenda Evropës, selia e të cilëve është jashtë territorit të Republikës së Kosovës, në rastet si në vijim:

- a) kur shteti anëtar, në të cilin është themeluar trupi për vlerësimin e konformitetit, ka vendosur të mos themeloj një trup kombëtar të akreditimit dhe nuk ka pasur rekurs (qasje) në trupin kombëtar të akreditimit të një shteti tjetër anëtar;
- b) kur trupi kombëtar i akreditimit nuk kryen akreditim në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit për të cilat kërkohet akreditim;
- c) kur trupi kombëtar i akreditimit në të cilin është krijuar trupi për vlerësim të konformitetit nuk i është nënshtruar me sukses vlerësimit kolegjial në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit për të cilat kërkohet akreditim.

Kur shteti i aplikuesit ka një trup të akreditimit që e mbulon fushën e akreditimit që kërkohet nga klienti dhe gjithashtu është nënshkrues i EA MLA/BLA dhe/ose ILAC MRA, atëherë DAK i propozon klientit të kërkojë akreditim tek trupi i tyre kombëtar i akreditimit.

5.2 Aplikimi nga një TVK që ndodhet jashtë Evropës

Një TVK që ndodhet jashtë Evropës mund të aplikojë për akreditim tek DAK në një nga situatat më poshtë:

- Trupi vendor i akreditimit nuk ofron fushën e plotë të kërkuar të akreditimit (duke përfshirë standardet dhe skemat sektoriale);
- Trupi vendor i akreditimit nuk është nënshkrues i EA/BLA dhe/ose ILAC MRA;
- Nuk ekziston trup vendor i akreditimit në shtetin ose ekonominë;
- Ka preferenca të bazuara në arsye komerciale ose arsye të tjera biznesi;
- Konsumatorët e trupit kërkojnë një akreditim specifik dhe nuk binden të pranojnë një akreditim ekuivalent;
- Trupi është pjesë e një zinxhiri të trupave për vlerësim të konformitetit me një pronar të vetëm, i cili dëshiron që të gjithë trupat të jenë në gjendje të ofrojnë të njëjtin certifikim të akredituar.

Në rastet e mësipërme, në varësi të situatës, mund të zbatohen një nga hapat e përmendur më poshtë.

Në rast se ka një trup akreditimi nënshkrues të EA/BLA dhe/ose ILAC MRA në shtetin ose ekonominë e TVK-së, DAK duhet:

- të hetojë nëse TVK-n aplikuese është në dijeni të trupit vendor të akreditimit nënshkrues të EA/BLA dhe/ose ILAC MRA;
- të informojë TVK-n aplikuese që akreditimi mund të kryhet në mënyrë më ekonomike nga një trup vendor i akreditimit nënshkrues i EA/BLA dhe/ose ILAC MRA;
- të theksoj ekuivalencën e akreditimit vendor të demonstruar përmes EA/BLA dhe/ose ILAC MRA.
- të theksoj që, në rast se aplikimi pranohet, DAK mund të përfshijë trupin vendor të akreditimit në procesin e akreditimit.
- të informoj trupin vendor të akreditimit nënshkrues i EA/BLA dhe/ose ILAC MRA mbi pranimin e aplikacionit përkatës, me dakordimin e TVK aplikuese.

Nëse TVK-ja kërkon akreditim edhe tek DAK por edhe tek trupi vendor i akreditimit nënshkrues i ILAC MRA, atëherë DAK duhet:

- të marrë informacion nga trupi vendor i akreditimit në lidhje me aktivitetet e mëparshme të akreditimit;
- të marrë parasysh rezultatet e vlerësimeve të trupit vendor të akreditimit, gjatë planifikimit të planit të tij të vlerësimit për TVK.

DAK mund të kërkojë nga trupi vendor i akreditimit nënshkrues i EA/BLA dhe/ose ILAC MRA të sigurojë staf për ekipin e vlerësimit të DAK, sa herë që është e mundur, ose mund të propozojë një vlerësim të përbashkët.

Nëse trupi vendor i akreditimit nuk është nënshkrues i EA/BLA dhe/ose ILAC MRA, atëherë DAK informon trupin vendor të akreditimit për pranimin e aplikacionit të akreditimit nga shteti i tij.

6. ANEKSET

Nuk aplikohet

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të aplikuara
02.12.2015	Ibush Luzha	Dokument i ri.
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01

